



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 306, Datë 23.10.2023

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K., PËR
MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET
HIPOTEKIMIT) TË ASETEVE FIKSE SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT
NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4, gërmat “a” dhe “b” dhe 10 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2048/10 prot., datë 20.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048 prot., datë 21.08.2023, i licencuari “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. dhe koncesionari “GENER 2” sh.p.k., kanë paraqitur kërkesën për marrjen e miratimit nga ERE për transferimin e aseteve të luajtshme e të paluajtshme (nëpërmjet barrësimit/hipotekimit) të shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., në favor të BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE sh.a., BANKËS SË TIRANËS sh.a. dhe UNION BANK sh.a.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 266, datë 06.09.2023, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme si mjet për garantimin e detyrimit, në favor të BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE sh.a., BANKËS SË TIRANËS sh.a. dhe UNION BANK sh.a.
- ERE me shkresën nr. 2048/4 prot., datë 14.09.2023 iu drejtua shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së saj dhe i evidentoi dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

- Shoqëria “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2048/7 prot, datë 28.09.2023 dhe nr. 2048/8 prot., datë 05.10.2023, dhe nr. 2047/9 prot., datë 17.10.2023, depozitoi në ERE dokumentacion plotësues.
- ERE me shkresën nr. 2281 prot., datë 13.10.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e kësaj procedure.
- Nga analiza përfundimtare e aplikimit, rezulton se shoqëria “DRAGOABIA ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” dhe “j”; pikën 3; pikën 4; dhe pikën 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016.
- Vlerësojmë që vullneti i bankave (BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE sh.a., BANKA E TIRANËS sh.a. dhe UNION BANK sh.a. ku të shprehet gatishmëria për të garantuar veprimtarinë e licencuar në rastin kryerjes së transferimit, të parashikohet si pjesë përbërëse e kontratës finale që do të nënshkruhet midis palëve, e të depozitohet në ERE.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të Fikse (nëpërmjet hipotekimit), në favor të BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE sh.a., BANKËS SË TIRANËS sh.a. dhe UNION BANK sh.a. (Lista e aseteve bashkëlidhur).
2. Shoqëria duhet të dorëzojë kontratën finale të nënshkruar, ku të përfshihet vullneti i bankave (BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE sh.a., BANKA E TIRANËS sh.a. dhe UNION BANK sh.a.) mbi gatishmërinë për të garantuar veprimtarinë e licencuar ne rastin e kryerjes së transferimit, si pjesë përbërëse të saj.
3. Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin nëpërmjet hipotekimit të aseteve të paluajtshme të shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta, në rast se do të ndodhi transferimi i këtyre aseteve nëse kjo kërkohet.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kudër të kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

ASETET E HEC DRAGOBIA + HEC ÇEREM

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Furnitori
1	PROJEKTI HEC DRAGOBIA (KOMPLET)			
1.1	HEC ÇEREM			
1.1.1	Rrugë Aksesi	ml	1	"Gener 2" shpk
1.1.2	Vepra e Marrjes	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.3	Stacioni i Pompimit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.4	Dekantuesi	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.5	Tuneli	ml	2,558	"Gener 2" shpk
1.1.6	Baseni i Presionit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.7	Tubacioni i Presionit	ml	1,513	"IMK" sha (Industria Metalurgjike Kosovë)
1.1.8	Godina e Centralit Çerem	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.9	Godina e Gjeneratorit dhe Transformatorit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.10	Vendroje tek Godina e Centralit Çerem	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.11	Vendroje Tubacioni i Presionit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.1.12	Vendroje tek Vepra e Marrjes Çerem	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2	HEC DRAGOBIA			
1.2.1	Rrugë aksesi	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.2	Vepra e Marrjes	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.3	Kabina Elektrike	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.4	Kanali Transportues	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.5	Dekantuesi	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.6	Tuneli Dragobi	ml	2,472	"Gener 2" shpk
1.2.7	Baseni i Presionit	copë	1	"Gener 2" shpk
1.2.8	Tubacioni i Presionit	ml	378	"IMK" sha (Industria Metalurgjike Kosovë)
1.2.9	Godina e Centralit	Lekë	1	"Gener 2" shpk
1.2.10	Vendroje tek Dekantuesi Dragobi	Lekë	1	"Gener 2" shpk
1.2.11	Vendroje tek Godina e Centralit Dragobi	Lekë	1	"Gener 2" shpk
1.3	LINJA E TRANSMETIMIT			
1.3.1	Linja nëntokësore Hec Çerem - Hec Dragobi - Nënstacion Shoshan	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.3.2	Linja ajrore Nënstacion Shoshan - Nënstacion Bajram Curri	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.3.3	Linja nëntokësore Shtylla Fundore nr. 1 - Nënstacioni Bajram Curri	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.3.4	Nënstacioni Shoshan	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.3.5	Nënstacioni Bajram Curri (Traku Shtesë)	copë	1	"Elb-Ndërtuesi" shpk
1.4	TURBINAT			
1.4.1	Turbinat për HEC Cerem (Tipi pelton) përfshirë gjeneratorët, panelet, çelät dhe të gjithë aksesorët e tjerë sipas specifikimeve teknike të projektit	copë	2	"Koessler" GmBH
1.4.2	Turbinat për HEC Dragobi (Tipi francis) përfshirë gjeneratorët, panelet, çelät dhe të gjithë aksesorët e tjerë sipas specifikimeve teknike të projektit	copë	3	"Koessler" GmBH

FIRMOSET NGA INVESTITORI
Subjekti "DRAGOBIA ENERGY" shpk

[Signature]
Datë 5.8.23



[Signature]



[Signatures]

ASETET E HEC DRAGOBIA + HEC ÇEREM

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Vlera Aseti
1	PROJEKTI HEC DRAGOBIA (KOMPLET)	Lekë	3,570,418,040
1.1	HEC ÇEREM	Lekë	1,042,382,919
1.1.1	Rrugë Aksesi	Lekë	33,017,668
1.1.2	Vepra e Marrjes	Lekë	110,496,178
1.1.3	Stacioni i Pompimit	Lekë	39,871,486
1.1.4	Dekantuesi	Lekë	82,071,740
1.1.5	Tuneli	Lekë	511,824,392
1.1.6	Baseni i Presionit	Lekë	21,714,532
1.1.7	Tubacioni i Presionit	Lekë	171,003,222
1.1.8	Godina e Centralit Çerem	Lekë	69,100,749
1.1.9	Godina e Gjeneratorit dhe Transformorit	Lekë	814,887
1.1.10	Vendroje tek Godina e Centralit Çerem	Lekë	941,640
1.1.11	Vendroje Tubacioni i Presionit	Lekë	1,001,525
1.1.12	Vendroje tek Vepra e Marrjes Çerem	Lekë	524,900
1.2	HEC DRAGOBIA	Lekë	1,648,095,839
1.2.1	Rrugë aksesi	Lekë	15,244,402
1.2.2	Vepra e Marrjes	Lekë	171,307,743
1.2.3	Kabina Elektrike	Lekë	138,122
1.2.4	Kanali Transportues	Lekë	92,220,759
1.2.5	Dekantuesi	Lekë	90,571,387
1.2.6	Tuneli Dragobi	Lekë	878,258,768
1.2.7	Baseni i Presionit	Lekë	50,079,984
1.2.8	Tubacioni i Presionit	Lekë	166,220,257
1.2.9	Godina e Centralit	Lekë	182,735,161
1.2.10	Vendroje tek Dekantuesi Dragobi	Lekë	609,674
1.2.11	Vendroje tek Godina e Centralit Dragobi	Lekë	709,582
1.3	LINJA E TRANSMETIMIT	Lekë	339,844,163
1.3.1	Linja nëntokësore Hec Çerem - Hec Dragobi - Nënstacion Shoshan	Lekë	70,787,329
1.3.2	Linja ajrore Nënstacion Shoshan - Nënstacion Bajram Curri	Lekë	66,831,944
1.3.3	Linja nëntokësore Shtylla Fundore nr. 1 - Nënstacioni Bajram Curri	Lekë	26,362,976
1.3.4	Nënstacioni Shoshan	Lekë	155,369,737
1.3.5	Nënstacioni Bajram Curri (Traku Shtesë)	Lekë	20,492,176
1.4	TURBINAT	Lekë	540,095,120
1.4.1	Turbinat për HEC Cerem	Lekë	230,677,700
1.4.2	Turbinat për HEC Dragobi	Lekë	309,417,420
	TOTALI	Lekë	3,570,418,040



FIRMOSET NGA INVESTITORI
Subjekti "DRAGOBIA ENERGY" shpk

Datë 5.10.25

